




**NJË SISTEM I MBUSHUR
ME HUMANITET**

TË DREJTAT E NJERIUT

OLTION (12), FATJON (13), ERALED (12), ATLANTIK (12), ERORA (12), ALBINA (12), ELMEDINA (13),
RINESA (12)



Barazia, synimi i demokracisë

U gëzuar shumë kur e kuptuam që do të vinim në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“. Mezi e pritëm këtë ditë, sepse kujdestarja e klasës na tregoi se do të zhvillonim aktivitete të ndryshme në këtë Punëtori. Kështu edhe ndodhi. Kur erdhëm këtu, u njoftuam me edukatorët, zhvilluam aktivitete, u bëmë gazetarë të Kuvendit dhe u ndamë në grupe për t'i filluar punës. Në grup diskutuam për demokracinë dhe rolin tonë si fëmijë në shoqëri. Pas diskutimit, i ndamë rolet dhe filluam punën tonë. Disa prej nesh, filluan të vizatojnë dhe disa të shkruajnë. Ne jemi ndjerë të barabartë dhe të lirë për t'i shprehur mendimet tona. Po ashtu, jemi ndjerë të respektuar, sepse siç e dijmë, respekti është element shumë i rëndësishëm në demokraci dhe në jetën tonë. Pra, ne duhet t'i respektojmë mendimet e të tjerëve dhe çdo gjë që na rrethon. Nëse i respektojmë mendimet e të tjerëve dhe nëse bashkëpunojmë me të tjerët do të jemi më të angazhuar në të gjitha aspektet.

Fjala demokraci rrjedh nga fjalët e lashtë greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ udhëheqje. Demokracia për herë të parë u shfaq në Athinë në kryeqytetin e Greqisë rreth vitit 507 para erës sonë. Në atë kohë kishin të drejtë vetëm burrat e pasur athinas të merrnin vendime. Kurse, skllëvërit, të varfërit dhe gratë nuk e kishin këtë të drejtë. Por, me kalimin e

kohës ndodhën ndryshime historike, të cilat mundësuan që sot të gjithë të gëzojnë të drejtën e vendim-marrjes në vendin e tyre, pa asnjë dallim.

Prandaj, sot demokracia është e përhapur në shumicën e vendeve të botës dhe në këto vende, secili i ka të drejtat e barabarta. Të drejtat e njeriut janë: e drejta e shprehjes së mendimeve, e drejta e lojës, e drejta e strehimit, e drejta e shkollimit, e drejta e familjes, e drejta e votës, e drejta e punës, e drejta e kujdesit shëndetësor, etj.


Kemi një mesazh për ju të dashur lexues: „Të bashkëpunojmë sa më shumë, sepse vetëm duke punuar së bashku dhe duke pasur mirëkuptim, mund të ndikojmë në zhvillimin e shtetit tonë.“



Grupi „8 Yjet“



Në demokraci ne e kemi të drejtën e kujdesit shëndetësor, por përgjegjësia jonë është të kujdesemi për shëndetin tonë



Edukimi, çelësi i suksesit tonë, për një ardhmëri sa më të mirë dhe një vend sa më të zhvilluar



Të gjithë jemi të barabartë dhe të lirë, dhe këto elemente të demokracisë bëjnë që të jetojmë një jetë paqësore



Në një vend demokratik, të gjithë e kemi të drejtën për të votuar të garantuar me ligj



Duhet të mendohe mi mirë para se të veproj më diçka



Vota sjell ndryshimin, prandaj votoni

NË DEMOKRACI UDHËHEQIM NE

ENDIJONA (12), FLORA (13), ERMIRA (12), FLORENT (12), MELOS (12), FATLIND (13), KASTRIOT (12)



Ne jemi nxënësit të cilët kemi mësuar për zgjedhjet. Në këtë artikull kemi vendosur të flasim për këtë temë

Një ditë po kthehesha nga shkolla. Isha duke ecur në rrugë, kur më lindi një ide. Pashë rrotull meje një rrugë të asfaltuar, ku nuk kishte as edhe një lule apo gjelbërim. Thashë me vete: „Përse nuk kemi një park në këtë vend?“ Ne me të vërtetë nuk kemi shumë parqe, mendova. „Kosova meriton më shumë gjelbërim dhe ambient të pastër, “ vazhdova unë me veten time. Këtë ide duhet ta ktheja patjetër në realitet. Kështu, mora telefonin dhe lajmërova shoqen time, Leonitën. Asaj i thashë se ne duhet ta formojmë një parti, e cila punon për të ndërtuar më shumë parqe. Në vendin tonë duhet të ketë më shumë gjelbërim dhe lule, në mënyrë që të kemi ajër më të pastër. Partia që dëshirojmë të formojmë në të ardhmen me Leonitën do ta ketë emrin „Partia e Gjelbër“. Bashkë me Leonitën do të përpiqemi ta rrisim partinë tonë, duke shtuar sa më shumë anëtarë të saj. Ne do të flasim me shumë qytetarë dhe do t’iu tregojmë për idenë tonë dhe për rëndësinë e ajrit të pastër në jetën e secilit prej nesh. Për të kthyer në realitet qëllimet e partisë sonë, ne duhet të kandidojmë kur të vie koha, për zgjedhjet shtetërore. Nëse ne marrim shumë vota, do të mund të punojmë më shumë parqe, të cilat do t’i premtojmë tek votuesit tanë. Këtë mund ta bëjmë vetëm nëse qytetarët na besojnë votat e tyre. Por, çfarë janë zgje-


dhjet? Në Kosovë banojnë 1.8 milion banorë. Të gjithë këta banorë votojnë në zgjedhjet, të cilat organizohen në Kosovë. Por, këta qytetarë duhet të mbushin 18 vjet për të fituar të drejtën e votës. Në shtetin tonë kemi dy lloje të zgjedhjeve. Ato janë zgjedhjet komunale ose lokale dhe zgjedhjet parlamentare ose qendrore. Në të dy këto zgjedhje, ne kemi parti të ndryshme dhe kandidatë të partive, të cilët kandidojnë për të fituar sa më shumë vota. Secila parti ka ide të ndryshme se si duhet të funksionoj shteti dhe komuna jonë. Kandidatët mund t’i përkasin ndonjë partie politike ose mund të jenë edhe kandidatë të pavarur. Ju mund të pyesni veten, përse është caktuar moshë 18 vjeçare për të votuar. Është pikërisht kjo moshë, sepse në këtë moshë ne jemi më të rritur. Kjo do të thotë se ne mund të bëjmë zgjedhjen më të mirë për të ardhmen e vendit. Ne premtojmë se do të jemi gjithmonë kaq aktiv dhe mendjehapur.



Gazetarët jo vetëm që shkruajnë saktë, por edhe bukur. Ne jemi fytyrat dhe duart prapa këtij artikulli kaq të mirë

KUVENDI NË JETËN TONË

ALBIN (12), DRILON (12), SHKELQIM (13), AIDA (13), ELVISA (11), ALBIONA (13),
LEONITA (11)



Sot mësuam për Kuvendin i cili luan rol shumë të rëndësishëm në jetat e të gjithë neve si qytetarë të demokracisë

Besimi është një djalë nga Klina. Ndonëse Besimi është person me nevoja të veçanta, ai ka të drejtë të punoj sikurse të gjithë qytetarët e tjerë. Këtë të drejtë

Mirëpo, asnjëherë nuk e kemi ditur sa i rëndësishëm është ai për jetën tonë. Gjatë diskutimit në grup, ne e kuptuam se arsyeja pse shkojmë në shkollë, pse kalojmë rrugën si këmbësorë në vend të caktuar që njihet si "shtegu për këmbësorë", pse duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare për të votuar dhe për të marrë patentë shoferin është për shkak se ekzistojnë ligjet. Falë këtyre ligjeve, ne kemi jetë të sistemuar dhe të rregulluar. E ky funksion i Kuvendit, njihet si funksioni legjislativ. Funksion tjetër i Kuvendit është funksioni përfaqësues, sepse siç e thamë, deputetët janë përfaqësuesit tanë. Si dhe funksioni i tretë është funksioni kontrollues, sepse Kuvendi kontrollon punën e Qeverisë. Ne shpresojmë që iu pëlqej artikulli ynë dhe e kuptuat se gjithçka që ndodh në Kuvend ndikon në jetat tona. Faleminderit që e lexuat këtë artikull. Ne gazetarët e grupit „Dijetarët“ iu përshëndesim.



ia mundëson demokracia. Kjo e drejtë e tij mbrohet me ligj. E ligjet janë rregulla të shkruara që miratohen në Kuvendin e Kosovës. Por, çka është Kuvendi? Kuvendi është institucioni më demokratik. Kjo për shkak se deputetët të cilët na përfaqësojnë neve qytetarëve në Kuvend, janë të zgjedhur pikërisht nga ne. Zgjedhja e tyre bëhet me vota. Prandaj, themi se Kuvendi është institucioni më demokratik.

Para se të vinim këtu në Punëtorinë „Demos-ti“ ne e kemi ditur se Kuvendi i Kosovës është i rëndësishëm.



Sot ishim gazetarë të Kuvendit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Emin Duraku“
Klasa: VII-2
Vendi: Sferkë, Klinë